



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:107434

Datë: 17.03.2025

Numri i dokumentit: 07001783

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.231/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit K.M nga Mitrovica, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Irfan Zushi me seli të zyrës në Vushtrri, për shkak të veprës penale *Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së*, i ngarkuar sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.152/2022, të datës 29.06.2022, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 12.03.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit dhe i pandehuri, në të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 17.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI K.M, nga i ati L..., e ëma G..., e vajzërisë K..., i lindur më ..., në Mitrovicë, ku edhe banon në adresën "...", me numër personal ..., të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar.

SHPALLET FAJTOR

Sepse:

Më date 02.07.2021, rreth orës 02:00, në rrugën "...", në Vushtrri, me qëllim që vetit t'i sigurojë përfitim të kundërligjshëm për vete ose tjetrin, ka tentuar përvetësimin e pronës së huaj të luajtshme, në atë mënyrë që me përdorimin e dhunës dhe mjetin e përshtatshëm – kacavide ka thyer rrezen e derës në lokalin free shop "...", që është pronë e A.M, ka hyrë në brendësi, e më

pas ka bërë rremujë – ka hapur sirtarin e tavolinës, e më pas kur është aktivizuar alarmi në lokal, i njëjti është frikësuar pas së cilës ka ikur nga vendi i ngjarjes.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale - *Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 38, 39, 40, 42, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 269, 276, 364 dhe 450 të KPPK-së,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 400€ (katërqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri refuzon të paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim, si dhe DËNIM ME BURGIM EFEKTIV në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III. Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.152/2022, të datës 29.06.2022 kundër të pandehurit K.M nga Mitrovica, për shkak të veprës penale *Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.*

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Klodina Gashi dhe i pandehuri K.M së bashku me mbrojtësin e tij, të caktuar sipas detyrës zyrtare, av. Irfan Zushi.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, po ashtu gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë këtë pranim fajësie të bërë nga i pandehuri, pasi që ky deklarim është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, e që janë prova të ligjshme të marra nga prokurori i shtetit. Gjykatës i ka propozuar që me rastin e marrjes së vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, të marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendesën e tij për veprimet që i ka kryer, kërkim faljen e tij të shprehur në gjykatë dhe moshën e tij, ndërsa si rrethanë rënduese ti merret rrezikshmëria shoqërore që rezulton nga këto vepra penale.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, me vetë faktin të konsultimit dhe bashkëbisedimit të tij me të pandehurin në lidhje me aktakuzën, në mënyrë vullnetare, pa imponim, pa premtim, pranon fajësinë mbi veprën penale të pambaruar apo në tentativë, duke iu drejtuar gjykatës nga ana e mbrojtjes që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe të marri parasysh masat lehtësuese duke ardhur në përfundim se që nga mbajtja e vuajtjes së dënimit tek i mbrojturi i tij ka ndikuar pozitivisht në risocializimin dhe përmirësimin e qëndrimeve të tij, që pas kryerjes do të kthehet si kontribut dhënës në familje dhe shoqëri.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë:

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuari vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) euro i cili dënim do të paguhet nga i akuzuari në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj gjobën, do ti zëvendësohet me burgim, ku për çdo 15 euro gjobë do të llogaritet një ditë burgim, po ashtu ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të akuzuarin për rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu ka shfaqur pendimin e tij, për veprën e kryer si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, faktin se këto vepra penale janë në rritje e sipër në territorin ku është kryer kjo vepër dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre dhe te natyrave të tjera e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.133/2021, P.nr.359/2021, P.nr.713/2021, P.nr.146/2021, P.nr.233/2021, P.nr.108/2021, P.nr.134/2021, P.nr. 259/2021, P.nr.237/2022, P.nr.405/2022, të gjitha këto për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1 të KPRK-së, dhe të gjitha vendime të formës së prerë, si dhe aktgjykimit P.nr.556/2021, i plotfuqishëm nga data 14.03.2022, për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë nga neni 318 të KPRK-së, dhe duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, gjykata vendosi që ndaj të akuzuari të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe ato renduese, si dhe faktit se vepra penale ka mbetur në tentativë, duke vlerësuar edhe kushtet ligjore të përcaktuar në nenin 28 par. 3 të KPRK-së, ku përcaktohet se *“Personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet”*, pra vetë ligji ka paraparë mundësinë që dënimi mund të zbutet, andaj gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 71 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, të KPRK-së, për të zbutur dënimin me burgim, dhe me këtë rast gjykata duke zbatuar nenin 72 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, ku përcaktohet se *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej tre (3) viteve, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”*, andaj gjykata pasi që gjeti rrethanat lehtësuese të përshkruara si më lartë, zbuti dënimin e të pandehurit për veprën penale *Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së*, në të cilin është paraparë shqiptimi i dënimit me burgim prej tre (3) viteve deri në shtatë (7) vite, e që dënimin me burgim e zbuti nën dënimin minimal prej tre (3) viteve, duke i shqiptuar të pandehurit dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Gjykata erdhi në përfundim se lartësia e dënimit me gjobë prej 400 (katërqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej një (1) viti, janë dënime në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko-civil, gjykata e ka bërë konform nenit 462 par. 2 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.231/2022, datë 17.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekaliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.